

Kodeksi për sjelljen etike të stafit akademik

(Bazuar në projektin e Këshillit të Evropës “Forcimi i Integritetit dhe Luftimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë”, tetor 2018).

Anëtarët e stafit akademik të emëruar sipas dispozitave të Ligjit për arsimin e lartë pritet të sillen në përputhje me parimet e mëposhtme, që rrjedhin nga burimet ndërkombëtare: integriteti; ndershmëria; e vërteta; transparencja; respekti për të tjerët; mirëbesimi; llogaridhënia; paanësia; barazia, drejtësia dhe drejtësia sociale; vetëmohimi; objektiviteti; sinqeriteti; lidhshmëria; liria akademike. Këto parime zbatohen në marrëdhëniet e tyre me (I) organin drejtues, atë menaxherial dhe organet e tjera të institucionit, (II) stafin tjetër akademik dhe mbështetës, (III) studentët dhe (IV) me çdo person ose grup tjetër që ka lidhur marrëveshje ose mbi ndonjë bazë tjetër, ose interes për punën e institucionit.

1. Të përgjithshme

Interesat e institucionit duhet të vendosen mbi interesat personale dhe askush nuk duhet të përfitojë nga pozicionet e tij/saj, ndryshe nga ajo se çfarë parashikohet me legjislacionin në fuqi; Të gjithë duhet të jenë të përkushtuar dhe të kujdesen për reputacionin e institucionit.

- Nuk duhet të pranohet asnjë urdhër nga jashtë për të vepruar ose për t'u përmbajtur nga veprimi në një mënyrë të caktuar, nga cilido individ, autoritet më i lartë ose nga ndonjë parti politike, sindikatë ose grup fetar, përveç nëse kjo lejohet nga legjislacioni në fuqi;
- Në lidhje me cilindo person ose grup brenda ose jashtë institucionit, anëtarët e stafit akademik nuk duhet të kërkojnë ose të pranojnë ryshfet ose formë tjetër financiare të paligjshme, ose të kërkojnë apo pranojnë ndonjë favor tjetër personal, që mund të ndikojë në punën e tyre dhe menjëherë duhet të raportojë çdo përpjekje për ryshfet ose të ofrojë favor personal për autoritetin përkatës të përcaktuar në rregulloret e institucionit, *i cili është i detyruar të ndërmarrë veprime të duhura*;
- Ata duhet të sigurohen se të gjithë personat nën autoritetin e tyre të jenë të njoftuar me legjislacionin relevant dhe me rregulloret përkatëse dhe pasojat e mosrespektimit, si dhe të promovojnë sjelljen etike;
- Ata kanë të drejtë të raportojnë çfarëdo pretendimi për mosrespektim të legjislacionit në fuqi, ose parimeve etike deri te autoriteti përkatës, në mirëbesim, pa pasojat negative personale, *duke pranuar se për çdo informacion i cili do të vërtetohet si rremë, do të ngrihet procedurë disiplinore*;
- Ata nuk duhet t'i keqpërdorin burimet e institucionit, ose informacionet personale apo tregtare që i posedojnë, veçmas edhe ato për pronësinë intelektuale, për përfitime personale ose të ndonjë personi apo grupi tjetër.;
- Ata duhet të jenë të përkushtuar ndaj ndershmërisë individuale dhe llogaridhënies ndaj Fakultetit/Departamentit.

2. Zgjedhja në thirrje dhe promovimi

- Anëtarët e stafit akademik duhet të dorëzojnë deklaratë me shkrim deri te Rektori, *i cili do ta njoftojë Bordin për deklaratën*, kur ata ose ndonjë anëtarë i familjes së tyre të ngushtë kanë ndonjë interes personal për çështje që ndikojnë në punën e tyre - burimet njerëzore (përfshirë zgjedhjet në thirrje dhe

promovimet e stafit), çështje financiare, kontraktuale ose çështje të tjera të rëndësishme;

- Kur marrin pjesë në zgjedhje për thirrje, promovim ose në komisione të tjera që kanë ndikim mbi stafin akademik, duhet të sillen sipas parimeve etike, të përcaktuara më sipër.

3. Hulumtimi shkencor

- Kur marrin pjesë në aktivitete hulumtuese, ata nuk duhet të përfshihen me plagjiaturë, nuk duhet që punën e të tjerëve t'ia atribuojnë vetvetes, nuk duhet t'i falsifikojnë rezultatet dhe duhet t'u përmbahen parimeve etike në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimeve të tjera specifike, në fushat e përcaktuara lëndore sipas rregullove të institucionit (për shembull në shkencat mjekësore, veterinare dhe hulumtimet sociologjike);

4. Provimet dhe vlerësimet

- Kur marrin pjesë në komisione, ose organe të tjera lidhur me pranimin, vlerësimin, provimin dhe veprime të tjera që kanë të bëjnë me studentët dhe në aktivitete individuale dhe grupe me studentët, duhet të sillen sipas parimeve etike të përcaktuara më sipër;

5. Marrëdhëniet ndërnjerëzore

- Të gjithë anëtarët e stafit akademik janë të përkushtuar për të njëjtat synime prandaj ata duhet t'i respektojnë të njëjtat vlera etike, njerëzore dhe të punës. Ata janë të gjithë kolegë. Ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin në veprimtaritë hulumtuese-shkencore dhe arsimore;
- Ata duhet të komunikojnë mes tyre në një mënyrë të sjellshme dhe ta respektojnë personalitetin e tjetrit, punën, pikëpamjet e tyre. Ata duhet t'i vlerësojnë arritjet e tyre në mënyrë objektive, si dhe duhet të tregojnë respekt të duhur ndaj të gjithë palëve të interesuara;
- Është e dëshirueshme të përdoret termi "koleg" kur t'i drejtohem njëri-tjetrit. Anëtarët e stafit akademik duhet ta përdorin formën e sjellshme (vetën e dytë shumë në gjuhët lokale), por nëse janë afër njëri-tjetrit, ata mund ta përdorin vetën e dytë njëjës. Rekomandohet të jenë reciprok në këtë drejtim.

6. Kodi i veshjes

- Veshja dhe paraqitja e duhur dhe e denjë është e dëshirueshme gjatë periudhave mësimore, si dhe pamja zyrtare gjatë mbrojtjeve të tezave dhe ngjarjeve zyrtare të Universitetit.

Këto norma të Kodit të Sjelljes në Universitetin e Evropës Juglindore janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e stafit akademik. Ata e obligojnë veten me nderin e tyre që t'i kultivojnë dhe t'i kryejnë detyrat e tyre, si pjesë përbërëse të karrierës dhe veprimtarive të tyre akademike.